



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1775/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Faton Bajrami dhe Ramush Bardiqi, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Bajraktari shpk me seli në Prishtinë përfaqësuar nga Z. F., dejtore i zyrës për shërbime juridike “Fetoshi Laë”, kundër të paditurës 1.Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson E. P., 2. Komuna e Mitrovicës së Jugut, përfaqësuar sipas autorizimit nga avokati Isuf Zejna, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.243/22 të datës 20.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.12.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditësit Bajraktari shpk me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.243/22 të datës 20.05.2024, VËRTETOHET

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.243/22 të datës 20.05.2024, është Refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Bajraktari shpk me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar nga gjykata anulimin e vendimit PSH nr.512/19 datës 11.09.2019, dhe të detyrohet e paditura e dytë Komuna e Mitrovicës që të kompensoj dëmin material dhe fitimin e humbur, me kamatë ligjore prej 8% në vit nga data e parashtrimit të padisë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, për shkak të: shkeljeve thelbësore të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që ankesa e paditësit të aprovohet si e bazuar, të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.243/22 të datës 20.05.2024, dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në procedurën administrative të ankesave, e paditura Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, me vendimin PSH. nr.512/19 dt.11.09.2019, ka aprovuar pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Milenium Konstruktion shpk& Bajraktari shpk &Integral shpk Vushtri, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirmbajtja, ngritja dhe revitalizimi I sipërfaqeve të gjelbëruara dhe parqeve në qytet” me nr.prokurimit 642-19-4378-5-1-1 të inicuar nga autoriteti kontraktues AK Kuvnedi Komunal Mitrovicë.

Paditësi Bajraktari shpk me seli në Prishtinë, i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Paneli Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 14.10.2019, me pretendim se vendimi i të paditurës është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhomat e shkallës së parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimit të paditues OSHP-së, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor datës 17.04.2024, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar. Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata vleron se vendimi i të paditues është i drejtë dhe i ligjshëm, duke dhënë spjegimet ligjore dhe faktike përkitazi me ligjshmërin e veprimeve të paditues dhe autoritetit kontraktues me rastin e eliminimit të paditësit nga aktiviteti i prokurimit me titull: “Mirmbajtja, ngritja dhe revitalizimi i sipërfaqeve të gjelbëruara dhe parqeve në qytet” me nr.prokurimit 642-19-4378-5-1-1 të inicuar nga autoriteti kontraktues A.K. Kuvendi Komunal Mitrovicë. Gjykata

ka vlersuar si të drejta vlersimet e A.K. për shkak se paditësi nuk ka plotësuar kërkesat e tenderit sa i përket punëve të kyera të ngjashme, paditësi ka ofertuar me çmim më të lartë se sa oferta e O.E. të rekomandur për kontratë. Gjykata vendimin e mbështet në dispozitat e nenit 17 par.3, 57,71 të LPP-së.

Qëndrimin juridik të Dhomës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Dhoma e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë i'u ka referuar dispozitave ligjore të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik.

Sa i përket pretendimeve ankimore se vlersimet e gjykatës së shkallës së parë nuk janë të drejta pasi që sa i përket kërkesës së dosjes së tenderit në lidhje me punët e kryera, paditësi ka ofruar dëshmi për punë të njëjta, se paditësi ka ofertuar me çmim më të lirë se sa O.E. i rekomanduar për kontratë, e sqaruar edhe nga eksperti shqyrtues i OSHP-së, ashtu që gjykata nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike, Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, nuk i aprovoi këto pretendime si të bazuara ndërsa aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij i janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Edhe Kolegji i vleron si të drejta dhe të bazuara vendimet e të paditurit dhe Dhomës së shkallës së parë, pasi që paditësi nuk ka plotësuar kriteret e dosjes së tenderit nga autoriteti kontraktues, ku disa nga pozicionet e e kontratave për punët e kryera të prezantuara nuk janë të njëjta me kontratat e kërkuara nga A.K., dhe se oferta me çmim është më e lartë se sa oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar.

Në këtë rast paditësi ka pasur obligim ti përmbahen kërkesave ligjore nga dosja e tenderit të autoritetit kontraktues, për ta arsyetuar ofertën e prokurimit publik, respektivisht në rastin konkret është respektuar dispozita e nenit 60 të LPP-së.

Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se nuk kemi vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, apo aplikim të gabuar të drejtës materiale, dhe se arsyetimi i Dhomës së shkallës së parë është i drejt, i ligjshëm dhe i mbështetur në prova dhe fakte, pasi që Dhoma e shkallës së parë e ka arsyetuar vendimin e saj duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi. Prandaj, edhe Kolegji vlerëson se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga dhoma e shkallës së parë dhe i padituri, drejtë janë zbatuar dispozitat e LKA-së dhe të Ligjit për Prokurim Publik.

Dhomat e Shkallës së Dytë i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera të palës ankuese në ankesë mirëpo, të njëjtat ishin të pa bazuara dhe nuk kishin ndonjë ndikim në vendosje ndryshe, andaj edhe vendosi që aktgjykimin e shkallës së parë ta vërteton si të drejtë dhe të ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, lidhur me nenin 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1775/24 datë 05.12.2024

Kryetar i kolegjit,

Krenar Berisha